



Neni 6

Pas nenit 32/1 shtohet neni 32/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 32/2

Pezullimi i avokatit të shtetit

1. Nëse ka prova që vërtetojnë se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga avokatit i shtetit, ndaj të cilit ka filluar një procedim disiplinor, pengon hetimin administrativ apo mund të cenojë ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij, Komisioni i Disiplinës vendos pezullimin e avokatit të shtetit ose merr çdo masë tjetër të përshtatshme deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

2. Pezullimi zgjat deri në marrjen e vendimit përfundimtar, por, në çdo rast, jo më shumë se 3 (tre) muaj.

3. Avokati i Shtetit përfiton 50% të pagës gjatë periudhës së pezullimit.

4. Në përfundim të procesit disiplinor, në rast se nuk konstatohen shkelje disiplinore të avokatit të shtetit, ky i fundit përfiton diferencën e pagës për periudhën e pezullimit.”.

Neni 7

Në nenin 33 pas paragrafit të parë shtohet paragrafi i dytë me këtë përmbajtje:

“Për ankimin e paraqitur ndaj masës disiplinore “shkarkim nga detyra”, zgjidhja e pasojave, për aq sa nuk parashikohet nga ky ligj, rregullohet sipas dispozitave të Kodit të Punës.”.

Neni 8

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 2 të këtij ligji.

2. Ngarkohet Avokati i Përgjithshëm i Shtetit që brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të bëjë shtesat dhe ndryshimet e nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 2.11.2023.

Shpallur me dekretin nr. 336, datë 23.11.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET

Nr. 336, datë 23.11.2023

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 91/2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, të ndryshuar.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

LIGJ

Nr. 92/2023

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 116/2014,
“PËR AKREDITIMIN E ORGANEVE TË
VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”¹**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 116/2014, “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Numri CELEX: 32008R0765, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 218, datë 13.8.2008, faqe 30–47.

¹ Ky ligj është përafuar pjesërisht me rregulloren (KE) nr. 765/2008, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 9 korrik 2008, “Për përcaktimin e kërkesave për akreditimin dhe shfuqizimin e rregullores (KEE) nr. 339/93”, e ndryshuar.



Neni 1

Pas pikës 16, të nenit 3, shtohet pika 17 me këtë përmbajtje:

“17. “Biobankë” është një organ që ruan mostra biologjike njerëzore dhe informacione shoqërore të organizuara në mënyrë sistematike për qëllime kërkimore.”.

Neni 2

Në pikën 1, të nenit 5, bëhen ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:

a) shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“c) organe certifikuese të personave;”;

b) pas shkronjës “e” shtohen shkronjat: “ë”, “f” dhe “g” me këtë përmbajtje:

“ë) organe që kryejnë verifikimin dhe vlefshmërinë si aktivitet të vlerësimit të konformitetit;

f) biobanka;

g) organe të tjera që kryejnë veprimtari të vlerësimit të konformitetit.”.

Neni 3

Pas shkronjës “g”, të nenit 6, shtohet shkronja “gj” me këtë përmbajtje:

“gj) promovon rolin dhe rëndësinë e akreditimit.”.

Neni 4

Në nenin 9 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit organizohet në mënyrë të pavarur nga organet e vlerësimit të konformitetit që ajo vlerëson dhe nga ndikimet tregtare të tyre, si dhe siguron mënjanimin e konfliktit të interesave.”.

2. Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“7. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit krijon procedurat e nevojshme për të siguruar menaxhimin efikas dhe kontrollet e duhura të brendshme. Kontrollet e brendshme kryhen nga auditues vendas ose të huaj, me kompetencë në fushën e akreditimit.”.

Neni 5

Pika 2 e nenit 15 ndryshohet si më poshtë:

“2. Të ardhurat e krijuara nga aktiviteti i Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, sipas

pikës 2, të nenit 5 të ligjit, përdoren në masën 90 për qind nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për:

a) pagesën e vlerësuesve teknikë vendas, që nuk janë punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, të vlerësuesve teknikë të huaj dhe të audituesve vendas ose të huaj;

b) shpenzimet e akomodimit e të transportit të vlerësuesve teknikë dhe audituesve vendas ose të huaj;

c) shpenzimet e trajnimeve dhe zhvillimin e vlerësuesve teknikë e të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit;

ç) promovimin e akreditimit;

d) përmirësimin e infrastrukturës së akreditimit.”.

Neni 6

Pika 1 e nenit 17 ndryshohet si më poshtë:

“1. Ankimi kundër vendimit të dënimit administrativ mund të bëhet brenda 30 ditëve nga data kur ankimesi ka marrë njoftim të drejtorit të Përgjithshëm të Akreditimit, i cili përgjigjet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e ankimit.”.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 2.11.2023.

Shpallur me dekretin nr. 337, datë 23.11.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET**Nr. 337, datë 23.11.2023****PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 92/2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 116/2014, Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**